

VENDIM
Nr. 771, datë 16.9.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
BULEVARDIT "PETRO N. LUARASI", TË BASHKISË SË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i bulevardit "Petro N. Luarasi", sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë "truall", me sipërfaqe të përgjithshme 50, 2 (pesëdhjetë presje dy) m², në vlerën 2 867 725 (dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 867 725 (dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.
 6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia e Tiranës.
 8. Regjistrimi i ri i pasurisë "truall", prej 50, 2 (pesëdhjetë presje dy) m², për ndërtimin e rrugës, të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Bashkia e Tiranës, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**Lista emërore e pronarëve, pasuritë e të cilëve do të shpronësohen për ndërtimin e Bulevardit
"Petro Nini Luarasi"**

NR.	EMËR MBIEMËR	Zona Kadstr.e	Nr. Pasur.	Sip. Përgj. Tr. në m ²	Sip. Prekur. Tr. në m ²	Çmimi për m ²	VLEFTA	Konfirmimi ZVRPP
1	Mandeta, Brunilda Gjata dhe Frida, Petrit Asllani	8160	3/1093	28,2	28,2	57,126	1.610.953	Shkr.nr.prot.21550/1, dt.18.12.13
2	Ylli Tabaku me bashkëpronarë	8160	3/379	22	22	57,126	1,256,772	Shkr.nr.prot.23304/1, dt.17.03.14
				50,2 m ²		Shuma	2.867.725	